



# **RAPORTI I PERFORMANCËS**

**Fondacioni Rural Credit Guarantee (RCGF)**

**Viti 2020**



## Përmbajtja

1. OBJEKTIVAT AND AKTIVITETET .....	3
2. ARRITJET AND PERFORMANCA .....	4
3. RAPORTIMI FINANCIAR .....	5
4. STRUKTURA, DREJTIMI DHE RAPORTIMI .....	7
Aneksi 1: Lista e Shkurtimeve .....	9



## 1. OBJEKTIVAT AND AKTIVITETET

Ky raport është përgatitur në përputhje me nenin nr. 22 (3) të Ligjit 25/2018 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare", të ndryshuar, ku organizatave jofitimprurëse në Shqipëri u kërkohet të përgatisin dhe publikojnë, së bashku me pasqyrat e tyre vjetore financiare, një raport të performancës. Ky raport përgatitet nga ato organizata jofitimprurëse që në pasqyrat e tyre financiare, shuma e aktiveve ose të ardhurave tejkalon vlerën 30 milion Lekë. Fondacioni "Rural Credit Guarantee" e plotëson këtë kusht. Qëllimi kryesor i raportit të performancës është të sigurojë që një organizatë jofitimprurëse t'i përgjigjet publikisht palëve të interesuara në paraqitjen e performancës së saj.

Fondacioni Rural Credit Guarantee ("RCGF" ose "Fondacioni") u themelua në korrik të vitit 2015, sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë. Ideja u konceptua si pjesë e kornizës IPA të BE-së, për të financuar një program "Programi për Garancinë e Kredisë Rurale" në Shqipëri me qëllim rritjen e të ardhurave familjare në zonat rurale të Shqipërisë. Aktivitetet u bashkëfinancuan nga BE dhe Qeveria e Shqipërisë për një vlerë totale prej 5.5 milion Euro, nga të cilat 5 milion Euro ishin nga BE dhe 0.5 milion Euro ishin nga Qeveria e Shqipërisë. Projekti fillestar, nga nëntori 2014 deri në mars 2016, u zbatua nga Banka për Zhvillim KfW.

Kapitali i fondacionit u rrit për një shtesë prej 30 milion Euro në dhjetor të vitit 2018 dhe një shtesë tjetër prej 6,76 milion Euro nga Qeveria Gjermane nëpërmjet Bankës për Zhvillim KfW, e cila vazhdon të mbështesë Fondacionin përmes ndihmës dhe konsulencës teknike.

Misioni i RCGF është të sigurojë qasje në financim, me qëllim zgjerimin e shërbimeve financiare në një segment pak të shërbyer të ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme në bujqësi, tregjet rurale si dhe sektorë të tjerë të ekonomisë, për shkak të mungesës ose pamjaftueshmërisë së kolateralit, për t'iu mundësuar atyre të mbijetojnë ose rimarrin disa aftësi të humbura, duke rezultuar në mbajtjen, krijimin ose ri-krijimin e vendeve të punës.

Objektivi i Fondacionit është të inkurajojë bankat dhe institucionet financiare jobanka të ofrojnë shërbime financiare për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme në sektorë të ndryshëm ekonomikë, përfshirë bujqësinë dhe sektorët e lidhur me të, mbi baza të qendrueshme, për tu mundësuar krijimin e vendeve të reja pune, rritjen dhe konkureshmërinë në treg.

Për të arritur këtë objektiv, RCGF ka marrëveshje partneriteti me institucione financiare dhe siguron garanci të pjesshme që mbulon rrezikun e kredisë të lidhur me kreditë fillestare apo të zgjeruara rishtazi, për:

- a) ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme në sektorin agro specifiku, zonat rurale në përgjithësi, dhe në sektorë të tjerë të ekonomisë.
- b) institucionet financiare jobanka për kreditim të ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme në sektorin agro specifiku dhe zonat rurale në përgjithësi.

RCGF përmbush misionin e saj përmes një mekanizmi garancie të ndarjes së rrezikut për:

- a) kredi bankare për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme në sektorin bujqësor në mënyrë specifike, në zonat rurale në përgjithësi, dhe sektorët e tjerë të ekonomisë.
- b) kredi komerciale për institucionet financiare jobanka me qëllim kreditimin e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme në sektorin e bujqësisë në mënyrë specifike dhe në zonat rurale në përgjithësi.

RCGF është një fondacion që operon në mënyrë direkte dhe të pavarur në Shqipëri, nuk ka filiale dhe nuk është i lidhur me asnjë fondacion tjetër.



## 2. ARRITJET AND PERFORMANCA

Më 31 dhjetor 2020, RCGF përmes instrumentit të saj të garancisë, ka mbështetur më shumë se 7529 huamarrës bujqësorë dhe ndërmarrje të vogla dhe të mesme, për një total prej 33.3 milion Euro (nga të cilat 15.8 milion Euro ishin për institucionet financiare jobanka), duke rezultuar në afro 4327 vende të reja pune, dhe 7017 punë të mbajtura kryesisht në sektorin e bujqësisë dhe ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, siç paraqiten në tabelën nr.1 më poshtë. Llogaritjet janë realizuar nga RCGF bazuar në të dhënat e raportuara nga institucionet financiare partnere (banka dhe institucione financiare jobanka).

Numri i punëve		
Punë të krijuara	Banka	1169
	Institucione mikrofinanciare jobanka	3158
	<b>Totali</b>	<b>4327</b>
Punë të mbajtura	Banka	1754
	Institucione mikrofinanciare jobanka	5263
	<b>Totali</b>	<b>7017</b>

*Tabela nr.1: Punë të krijuara dhe punë të mbajtura prej fillimit të aktivitetit të garancisë  
Burimi: Llogaritje të RCGF*

RCGF nuk është e kufizuar në ndonjë zonë gjeografike ose aktivitet biznesi në Shqipëri, për sa kohë që këto sektorë nuk janë në listën e përjashtimeve. Për më tepër, ka edhe limite të kredive sic janë të parashikuara në marrëveshjet e financimit.

Në Dhjetor 2019, një shpërthim i një lloji të ri të koronavirusit, Covid-19, u shfaq në Wuhan, Kinë. Brenda disa javësh, pavarësisht përpjekjeve për të izoluar virusin në Kinë që përfshinte mbyllje të gjerë të qyteteve dhe bizneseve, numri i të infektuarve u rrit ndjeshëm, dhe përtej kufijve të Kinës, përfshirë Shqipërinë. Më 11 Mars 2020, Organizata Botërore e Shëndetit njoftoi një situatë pandemie për shkak të emergjencës globale të shkaktuar nga shpërthimi i Covid-19. Përhapja e koronavirusit ende po evoluon dhe efektet e saj mbeten të panjohura.

Më 6 prill 2020, Bordi i Drejtorëve të Fondacionit ka aprovuar një produkt të ri (një dritare e re) të lançuar nga Fondacioni për kompanitë e prekura nga kriza aktuale e shkaktuar nga Covid-19, që ka si qëllim të sigurojë në mënyrë të qëndrueshme akses në financim për aktivitetet e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme të ndikuara nga kjo krizë dhe nga masat e kolateralit te detyruar.

Fillimisht, fondet e alokuara nga RCGF për këtë dritare nga fondet e kapitalit ekzistues janë 10 milion Euro. Më pas, RCGF mori gjithashtu një fond prej 6.76 milion Euro në dhjetor 2020 nga KfW ekskluzivisht për dritaren Covid-19. Qëllimi është të kontribuojnë në rigjallërimin e ekonomisë në Shqipëri dhe gjenerimin ose ruajtjen e nivelit të punësimit në sektorët prodhues, përmes ndërmjetësimit me instrumentet financiare. Mundësia e lehtësimit është e përkohshme si për klientët aktualë, ashtu edhe për ato të rinj. Kjo gjë parashikohet të jetë në dispozicion deri në fund të vitit me mundësinë e zgjatjes, nëse kjo vlerësohet e nevojshme.



### 3. RAPORTIMI FINANCIAR

Në fund të vitit 2015, RCGF mori 3.57 milion Euro nga BE. Këto fonde u transferuan nga KfW në RCGF, bazuar në marrëveshjen financiare që RCGF dhe KfW kishin nënshkruar për veprimtarinë e garancisë.

Më tej, gjatë vitit 2015 dhe 2016, RCGF mori një grant prej 0.5 milion Euro nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural sipas Programit IPA 2012. Qëllimi i këtij granti ishte të kompensojë Fondacionin për shpenzimet operative të bëra.

Gjatë vitit 2018, KfW dhe RCGF nënshkruan një marrëveshje për një financim të ri deri në shumën 5 milion Euro, të ndarë në 2 këste prej 4.35 milion Euro dhe 0.65 milion Euro. Marrëveshja u nënshkrua në 12 Shtator 2018. Më vonë, gjatë këtij viti, më 5 Dhjetor 2018, KfW dhe RCGF nënshkruan një marrëveshje të re për një financim të ri, në shumën 25 milion Euro. Ndërsa në 20 dhjetor 2018 u disbursua kësti i parë i marrëveshjes së parë, dhe të gjitha fondet nga marrëveshja e dytë. Shuma totale e marrë në 2018 është 29.35 milion Euro. Qëllimi i këtij kontributi financiar ishte rritja e kapitalit të RCGF të përdorur për lëshimin e garancive në dobi të ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme në Dritaren e Rregullt dhe Dritaren e Gjellbër.

Gjatë vitit 2020, KfW dhe RCGF nënshkruan një tjetër marrëveshje për një financim të ri në shumën 6.76 milion Euro, për të rritur kapitalin e garancive të RCGF në përgjigje të pandemisë së Covid-19.

Këto fonde përdoren për të dhënë garanci për klientët nëpërmjet institucioneve bankare në baza ndarje risku 50/50 dhe me limit maksimal deri në 500,000 Euro për Dritaren e Rregullt dhe 250,000 Euro për Dritaren e Gjellbërt dhe garanton huamarrjet tregtare të institucioneve mikrofinanciare nga bankat lokale nën garanci të veçanta

Më 31 dhjetor 2020 garancitë e dhëna janë si më poshtë:

	<i>Vlera e mbetur (Lekë)</i>	<i>Vlera e disbursuar e garantuar (Lekë)</i>
Garanci për NOA	461,448,810	552,700,000
Garanci për FedInvest	256,665,000	375,800,000
Garanci për Fondi Besa	417,939,000	582,625,800
Garanci për klientët e Credins Bank	153,424,488	308,348,407
Garanci për klientët e BKT	67,471,149	157,614,849
Garanci për klientët e Union Bank	144,526,207	185,811,860
Garanci për klientët e Fibank	24,376,086	26,461,950
Garanci për klientët e OTP Bank	370,171,903	421,755,370
<b>Totali në Lekë</b>	<b>1,896,022,643</b>	<b>2,629,118,236</b>

Vlera e mbetur lidhet me vlerën e mbetur të huave të garantuara nga Fondacioni. Vlera e disbursuar e garantuar lidhet me vlerën e garantuar të huave të disbursuara, që është 50% e vlerës totale të disbursuar për institucionet bankare dhe 100% e vlerave të disbursuara për institucionet e mikro financimit.



Fondacioni ka investuar fondet e kapitalit në letrat me vlerë (bono thesari, obligacione, eurobonde) të lëshuara nga Qeveria e Shqipërisë dhe këto investime përdoren si kolateral për kontratat e garancisë financiare që u janë dhënë bankave dhe institucioneve financiare jobanka.

RCGF vazhdimisht kërkon institucione të reja partnere për të arritur misionin e saj. Më 31 dhjetor 2020, bankat dhe institucione financiare jobanka partnere të RCGF janë si më poshtë:

Banka:

- 1) Banka Kombëtare Tregtare (BKT)
- 2) Credins Bank
- 3) Union Bank
- 4) First Investment Bank (FiBank)
- 5) OTP Bank

Institucione Financiare jobanka:

- 1) NOA
- 2) Fedinvest
- 3) Fondi BESA

Fondacioni funksionin në bazë të parimit të vijimësisë, i cili supozon se Fondacioni do të vazhdojë të operojë në të ardhmen e parashikueshme, mbështetur në objektivin e lëshimit të garancive financiare. Bazuar në buxhetin e aprovuar, Fondacioni planifikon të rrisë aktivitetin e tij operacional dhe parashikon rezultate pozitive në vitin në vijim.



#### 4. STRUKTURA, DREJTIMI DHE RAPORTIMI

Fondacioni Rural Credit Guarantee është një fondacion i regjistruar sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë, njohur si 'RCGF', me NIPT L52004452B, me Vendim Gjykatë për themelimin e Fondacionit nr. 518, datë 08 korrik 2015, me adresë në rrugën 'Abdi Toptani', Torre Drin, kati 9, Nr. 93, 1001, Tirana, Albania.

RCGF drejtohet nga Drejtori Ekzekutiv i cili reporton në Bordin e Drejtorëve. Bordi i Drejtorëve është niveli më i lartë i qeverisjes, me 3 anëtarë, respektivisht Zj. Bahrije Dibra, përfaqësuese e Bankës për Zhvillim KfW, Zj. Lauresha Grezda përfaqësuese e Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, dhe Z. John Khoury, i cili aktualisht drejton Bordin, është nominuar nga KfW dhe Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

Struktura organizative e RCGF është paraqitur në figurën nr.1 më poshtë:



Figura nr. 1. Struktura organizative e RCGF

Sa i përket garancive financiare, Drejtori Ekzekutiv mund të angazhojë me kontratë Fondacionin për një vlerë deri në 500.000 Euro (ose ekuivalentin përkatës në lekë). Kontratat e garancisë financiare me vlerë që tejkalojnë shumën prej 500.000 Euro i nënshtrohen aprovimit paraprak të Bordit të Drejtorëve.

Donatorët e RCGF janë: KfW, Bashkimi European dhe Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

Një nga objektivat e KfW si një bankë zhvillimi dhe e BE-së, si një bashkim ekonomik dhe politik unik, është të sigurojë fonde për qeveritë, ndërmarrjet publike dhe bankat tregtare të angazhuara në mikrofinancë dhe promovimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme në vendet në zhvillim për të ndihmuar ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme të mbijetojnë ose të rimarrin disa kapacitete të humbura, duke mbajtur dhe krijuar vende punë. Ky objektivi përbën njëkohësisht misionin dhe qëllimin e RCGF.



Ky raport i Fondacionit më dhe për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2020, u përgatit nga Drejtimi i Fondacionit "Rural Credit Guarantee" në 15 qershor, 2021, dhe u aprovuar nga Kryetari i Bordit të Drejtorëve të RCGF:

*Përgatitur nga:*

*Bajram Korsita*

Z. Bajram Korsita  
Drejtör Ekzekutiv

Datë: 15 qershor 2021



*Aprovuar nga:*

*John P. Khoury*

Z. John P. Khoury  
Kryetar i Bordit të Drejtorëve

Datë: 7 korrik 2021





## Aneksi 1: Lista e Shkurtimeve

BE – Bashkimi European

IPA - Instrument for Pre-Accession Assistance

KfW - Kreditanstalt für Wiederaufbau

RCGF - Rural Credit Guarantee Foundation

SME – Small Medium Enterprises (Ndërmarrje të vogla, të mesme)